



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 20 mars 2012  
Nr. ref.: RK210/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI-131/11**

**Parashtruesit:**

**Qazim Gashi, Fadil Gashi, Agim Gashi dhe Ali Kelmendi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 197/2010, të datës 22 gusht 2011**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë Qazim Gashi, Fadil Gashi, Agim Gashi nga Ajvalia dhe Ali Kelmendi nga Mramori, që të gjithë nga Komuna e Prishtinës, të cilët para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përfaqësohen nga avokatët Shefki Sylaj dhe Visar Vehapi nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, i datës 22 gusht 2011, me të cilin konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1137/2009, i datës 25 maj 2010, dhe iu urdhërohet parashtruesve të kërkesës që të kthejnë patundshmëritë, të cilat momentalisht i mbajnë në posedim, personave të tretë të cilët në procedurat para gjykatës kanë dëshmuar pronësinë ndaj patundshmërive në kontest.

## **Objekt i çështjes**

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të datës 22 gusht 2011, duke pretenduar se me këtë vendim janë shkelur nenet 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Deri në vendimin përfundimtar të këtij kontesti ligjoro-pronësor mes parashtruesve dhe personave të tretë, lidhur me të drejtat e pronësisë mbi paluajtshmëritë, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës si vijon;

*“Kërkojmë masën e sigurisë – masën e përkohshme, mosndryshimin e gjendjes në terren në parcelën kadastrale 528, lista poseduese 933, Zona Kadastrale Çagllavicë.”*

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 13 tetor 2011, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Parashtruesit e kërkesës njëkohësisht kërkuan nga Gjykata Kushtetuese që të vendos masën e përkohshme, në mënyrë që të mos ndryshojë situata në ngastrën kadastrale 528, lista poseduese 933, Zona kadastrale e Çagllavicës.
8. Më 27 janar 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Komunale në Prishtinë, Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve lidhur me Rastin nr. KI-131-11.
9. Më 20 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarit Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë që të refuzojë kërkesën, në tërësi, si të papranueshme.
10. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë që të refuzojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës për masën e përkohshme, me arsyetimin se të njëjtit nuk kishin ofruar dëshmi që do të arsyetonte vendosjen e masës së përkohshme si të domosdoshme për të shmangur ndonjë dëm të pakompenzueshëm, apo dëshmi se një masë e tillë do të ishte me interes publik.

## Përmbledhje e fakteve

11. Më 10 dhjetor 2003, I. Th. dhe N. H. nga Prishtina, parashtruan ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për pengim në posedim, kundër parashtruesve të kërkesës dhe disa personave të tretë, që këtu nuk janë parashtrues kërkesë, me kërkesën që parashtruesit e kërkesës të lirojnë nga uzurpimi dhe mundësojnë shfrytëzimin e papengueshëm të patundshmërive që janë evidentuar si Ngastra nr. 528, në Zonën kadastrale të Çagllavicës, me kulturë bari të klasit të tretë dhe sipërfaqe prej 6.34,97 ha.
12. Gjykata Komunale në Prishtinë me procedurën C. Nr. 2140/3, të 7 shtatorit 2004, refuzoi kërkesën e paditësve I. Th. dhe N. H. dhe gjykoj në dobi të parashtruesve të kërkesës.
13. Më 27 dhjetor 2004, I. Th. dhe N. H. parashtruan ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur.
14. Më 14 mars 2007, parashtruesit e kërkesës kundër paditësve I. Th. dhe N. H., i propozuan Gjykatës Komunale në Prishtinë që të vendoste masën e përkohshme. Gjykata Komunale e Prishtinës kurrë nuk vendosi lidhur me masën e përkohshme, dhe në këtë mënyrë, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës „...u paraqjykua zgjidhja e çështjes në dobi të palës kundërshtare...“.
15. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, sipas ankesës së paditësit, me Aktgjykimin Ac. nr. 119/2005, të 3 prillit 2007, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës komunale në Prishtinë C. Nr. 2140/3, të 7 shtatorit 2004, dhe ktheu lëndën për rigjykim.
16. Më 17 tetor 2007, parashtruesit e kërkesës parashtruan kundërpadi kundër paditësve I. Th. dhe N. H., dhe kërkuan që „të vërtetohet e drejta e pronësisë përmes parashkrimit fitues ngastrën kadastrale nr. 528, fleta poseduese nr. 933, zona kadastrale Çagllavicë, me sipërfaqe prej 6.34.97 ha.“
17. Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, pjesërisht i aprovoi kërkesat e paditësve I. Th. dhe N. H., që të dy nga Prishtina, dhe i urdhëroi parashtruesit e kërkesës që t'u dorëzojnë paditësve pjesë të patundshmërisë, siç edhe ceket në pjesën operative të aktgjykimit. Njëkohësisht, refuzohet si e palejueshme kundërpadija e parashtruesve të kërkesës, kundër paditësve, në pjesën ku kërkesa ka të bëjë me konfirmimin e të drejtave në pronësi në ngastrën kadastrale nr. 528, vendi i quajtur Ajvali, me kulturë bari të klasës të tretë, Zona kadastrale e Çagllavicës, me sipërfaqe prej 6.34.97 ha.
18. Më 31 korrik 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, me propozimin që Gjykata e Qarkut në Prishtinë të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, dhe ta kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, ose ta ndryshojë atë dhe të miratojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës për kundërpadi.
19. Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin Ac. nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe pjesërisht ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, dhe urdhëroi parashtruesit e kërkesës që t'u dorëzojnë paditësve pjesë të patundshmërisë, siç edhe ceket në pjesën operative të aktgjykimit. Njëkohësisht, refuzohet si e palejueshme kundërpadija e parashtruesve të kërkesës - kundër paditësve, në pjesën ku kërkesa ka të

bëjë me konfirmimin e të drejtave në pronësi në ngastrën kadastrale nr. 528, vendi i quajtur Ajvali, me kulturë bari të klasit të tretë, Zona kadastrale e Çagllavicës, me sipërfaqe prej 6.34.97 ha.

20. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, në afatin e paraparë me ligj, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën për revizion, njëkohësisht edhe Prokuroria Publike e Kosovës parashtrroi kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës të anulonte aktvendimet e përmendura si të kundërligjshme.
21. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 197/2010, të 22 gushtit 2011, refuzoi si të pabazë kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës - kundër paditësve, si dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, në pjesën e operative, **në pjesën I nën 1, 3, dhe 4, pjesën II dhe III**, lidhur me parashtruesit e kërkesës Qazim Gashi, Fadil Gashi dhe Selim Gashi.
22. Pjesërisht u pranua si e bazuar kërkesa për revizion e të paditurve – kundër paditësve, si dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/2007, të 29 prillit 2009, në pjesën operative të aktgjykimit **I nën 2** vetëm lidhur me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi, si dhe duke ia kthyer këtë pjesë të lëndës gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

23. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 197/2010, të 22 tetorit 2011, duke deklaruar shkeljet si vijon:

*„Të paditurit (parashtruesit e kërkesës) – kundër paditësve kanë propozuar masën e përkohshme më datë 14/03/2007/ dhe nga Gjykata Komunale në Prishtinë asnjëherë nuk është vendosur mbi masën e përkohshme dhe në këtë mënyrë është prejudikuar zgjidhja e çështjes në favor të paditësve dhe janë shkelur në vazhdimësi nenet 31, 46, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe si pasojë e këtyre shkeljeve janë shkelur edhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe gjithë efekti i tyre i dobishëm.“*

*„Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C.nr. 713/07 ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 2 pika n. Al. 2 të LPK, ngase diapozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit dhe shkresat e lëndës.“*

*„Aktgjykimi i lartcekur përmban shkelje të natyrës së nenit 182.2 pika n., për shkak se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, ngase diapozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit. Aktgjykimi gjithashtu nuk përmban fare arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet të cilat i përmban janë të paqarta dhe kontradiktore etj.“*

*„Cenimi esencial i dispozitave të procedurës kontestimore konsiston edhe në faktin se aktgjykimi i lartcekur përmban të meta të tilla për shkak të së cilave juridikisht është i paqëndrueshëm. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se aktgjykimi i atakuar përkitazi me kundërpadinë e të paditurve kundër paditësve nuk përmban kurrfarë arsyetimi. Kundërpadia e të paditurve në një pjesë në diapozitivin nën III është refuzuar ndërsa në diapozitivin nën IV në një pjesë është hedhur poshtë si e palejuar.“*

„Ngase Gjykata kundërpadinë si të palejuar mund ta hedhë vetëm pas shqyrtimit paraprak të Padisë më së largu deri në seancën përgatitore dhe atë poqëse janë plotësuar kushtet nga neni I cituar më sipër, në rastin konkret nuk ka mundur të hidhet me aktgjykim por edhe me aktvendim në procedurën paraprake kundërpadia si e palejuar ngase nuk është plotësuar asnjë kusht i paraparë nga neni 391 i LPK.”

„Të njëjtat shkelje esenciale i ka bërë edhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë me Aktgjykimin AC.nr. 1137/2010/ kur e ka refuzuar ankesën e të paditurve – kundër paditësve.”

„Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të Procedurës Kontestimore kur si provë ka pranuar procesverbalin e vendshiqimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë me të cilin është konstatuar se KBI "Kosovo Export" nga Fushë Kosova e ka punuar ngastrën kadastrale kontestuese ngase në atë procedurë të paditurit – kundër paditësit nuk kanë qenë palë në procedurë dhe nuk kanë pasur mundësi që ta kundërshtojnë këtë pronë. Andaj ai procesverbal i ndonjë procedure tjetër nuk mund të merret si provë, nëse palëve në kontest nuk iu është dhënë mundësia ta kontestojnë -kundërshtojnë dhe se përmes dëshmitarëve të dëgjuar para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë është vërtetuar se parcelën kadastrale të cekur si më lartë të paditurit - kundër paditësit me mirëbesim e shfrytëzojnë që nga viti 1956.”

„Gjykata e Qarkut në Prishtinë duke vepruar si Gjykatë e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale kur kërkesëpadinë e të paditurve – kundër paditësve e ka refuzuar si të pabazuar ngase paditësit të drejtën e pronësisë në parcelën kadastrale nr. 528 e kanë fituar në bazë të Parashkrimit fitues, andaj është aplikuar gabimisht neni 28 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike si ligj në fuqi dhe neni 40 i Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore të Kosovës.”

„Të njëjtat shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale të cekura më lartë i ka bërë Gjykata Supreme e Kosovës duke e llogaritur afatin e parashkrimit fitues dhe duke mos marrë parasysh se të paditurit – kundër paditësit prej vitit 1956, në bazë të kontratës interne vijimisht kanë qenë dhe janë në posedim dhe shfrytëzim të patundshmërisë kontestuese sepse në të kanë të ndërtuara shtëpitë e banimit dhe objektet tjera përcjellëse qysh në vitet e 50 –ta.”

„ Duke u shkelur në mënyrë drastike dispozitat e lartcekura Procedurale dhe materiale, janë shkelur edhe nenet 31, 46, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe është shkelur edhe KEDNJ-a.”

24. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të 22 tetorit 2011, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës:

“Kërkojmë masën e sigurisë - masën e përkohshme, mosndryshimin e gjendjes në terren në ngastrën kadastrale 528, lista poseduese 933, Zona Kadastrale Çagllavicë.”

„Kërkojmë shpalljen e pavlefshme të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010/ të datës 22/08/2011, anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009 të datës 25/05/2010/ dhe Aktgjykimit të Gjykatës

*Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07 të datës 29/04/2009/. Dhe ta kthej çështjen në rishqyrtim.“*

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në pjesën që ka të bëjë me parashtruesit e kërkesës Qazim Gashi, Fadil Gashi dhe Agim Gashi**

25. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se bazë për parashtruesin e tyre janë nenet 31, 46 dhe 54 (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Mbrojtja e pasurisë dhe Mbrojtja gjyqësore e të drejtave) të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe e drejta mjete juridike efektive).
26. Kushtet e pranueshmërisë janë paraparë me Kushtetutë, më saktësisht specifikohen me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.
27. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:  
*„ Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.“*
28. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
29. Parashtruesit e kërkesës nuk i mbështetën me prova pretendimet e tyre, dhe as nuk paraqitën ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesit e kërkesës nuk cekin se si dhe në ç'mënyrë nenet 31, 46 dhe 54 e Kushtetutës, dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ mbështesin kërkesën e tyre, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
30. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se të drejtat e tyre janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe aplikimin e gabueshëm të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, pa qartësuar se në ç'mënyrë ato vendime kanë cenuar të drejtat e tyre kushtetuese.
31. Në këtë rast, parashtruesve të kërkesës u janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesin rastin e tyre dhe të kontestojnë interpretimin e ligjit për të cilin konsiderojnë se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
32. Nga kjo rrjedh se, kërkesa në pjesën që ka të bëjë me parashtruesit e kërkesës Qazim Gashi, Fadil Gashi dhe Agim Gashi është qartazi e pabazë në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, ku parashihet *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:  
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në pjesën që ka të bëjë me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi

33. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj“.*

34. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'ju ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se korniza ligjore e Kosovës do të sigurojë mjete efektive për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shihni, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite gjatë procedurës në fjalë. Derisa kjo çështje është cekur në mënyrë absolute ose substanciale, kërkesa mbi shterimin e mjeteve është plotësuar (shihni, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros nr. 56679/00, vendimi i datës 28 prill 2004).
35. Kjo Gjykatë e ka aplikuar këtë arsyetim me rastin e nxjerrjes së vendimit për papranueshmëri, të 27 janarit 2010, në bazë të mosshterimit të mjeteve juridike në rastin Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti nr. KI. 41 /09 dhe vendimit të 23 marsit 2010 në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rasti nr. KI 73/09.
35. Duke pasur parasysh këtë, dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur Gjykatës Kushtetuese nga parashtruesit e kërkesës, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të 22 gushtit 2011, pjesërisht është pranuar si e bazuar kërkesa për revizion e të paditurve – kundër paditësit, si dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Kështu që, anulohen Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009, i 25 majit 2010, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/2007, i 29 prillit 2009, në pjesën operative të Aktgjykimit **I nën 2** vetëm në lidhje me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi dhe kjo pjesë e lëndës i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, përderisa procedura për rigjykim ende nuk ka përfunduar. Prandaj, parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligj, në mënyrë që të mund të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
36. Nga kjo rrjedh se, kërkesa në pjesën që ka të bëjë me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi është e papranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 113.7 dhe rregullin 36. (1a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që *„Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
- a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimin të kundërshtuar...“.*

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47(2) të Ligjit, dhe rregullin 36 (1a) dhe 36 (2b) të Rregullore së punës, në seancën e mbajtur më 20 mars 2012, njëzëri



## VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme në tërësi;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për vënien e masës së përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Robert Carolan

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
  
Prof. dr. Enver Hasani